



REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVË
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

D.o.	03-02/DPK	Nr Prot.
D.o.		Br. Prot.
Nr. prot.		Prot No.
Nr. prot.		01-1605/16
Nr. prot.		Data
Nr. prot.		Datum
Nr. prot.		Date 26.04.2016

PIR SHKAK



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 26.04.2016, mori:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-02-4643/15, për zyrtarin e lartë z. Hajriz Sejdiu u.d. Drejtor i Departamentit te Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-4643/15,qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Hajriz Sejdiu u.d. Drejtor i Departamentit te Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit është vërejtur se zyrtari i lartë, z. Hajriz Sejdiu u.d. Drejtor i Departamentit të Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave figuron si Pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 22.02.2016 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Hajriz Sejdiu, ka ardhur ne takim në zyrat e AKK-së ku nga zyrtaret e AKK-së, është njoftuar me faktet qe posdon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar për situatë të Konfliktit të Interesit.

z. Hajriz Sejdiu, është pajtuar me gjendjen, por është arsyetuar se biznesi ne fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe ka ber kërkesë për shuarje dhe është zotuar se brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë dhe do te veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e konfliktit të interesit.

Me datën 22.04.2016, nga z. Sejdiu, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Hajriz Sejdiu ne mënyrë vullnetare ka shuar biznesin me emër N.SH“DDD Boemia” me nr.70223713, ku ka figuruar si person i autorizuar dhe pronar i këtij biznesit.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Hajriz Sejdiu u.d. Drejtor i Departamentit të Gatishmërisë në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, duke e shuar ne mënyrë vullnetare biznesin privat janë krijuar rrëthana të reja dhe ka shmangur konfliktin e interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

